



Planuar / Dorezuar Punime/Protokol Received/Deliverty	15-03-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinita Org./Unit	Nr Prot B/ Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM8HOK	1386/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.113/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.113/2022 të datës 10.02.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted].

[redacted] kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike „kontestim konkursi“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.113/2022 e datës 10.02.2022, e parashtruar nga ankuesja [redacted].

II. Mbetet në fuqi vendimi i Departamenti të Burimeve Njerëzore Nr.DM 256/2022 i datës 07.02.2022.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted], e punësuar në pozitën “Zyrtare e prokurimit” në Departamentin e Prokurimit, sipas Akt emërimit të datës 04.08.2014, ka aplikuar në konkursin sipas njoftimit të datës 15/12/2021 me afatin për aplikim nga data 14.01.2022 deri më 28.01.2022 me numër reference.RN00007978 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Me datë 02.02.2022 Departamenti i Burimeve Njerëzore me vendimin Nr.DM 252/2022 refuzon aplikacionin e znj. [redacted] me arsyetimin se e njëjta nuk i plotëson kriteret e përcaktuara të konkursit. Ankuesja e pakënaqur me vendimin e datës 02.02.2022 me Nr.DM 252/2022 të Departamentit të Burimeve Njerëzore me datën 04.02.2022 ka parashtruar ankesë

në Departamentin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit pas shqyrtimit të ankesës së ankueses me datë 07.02.2022 ka nxjerrë vendimin me nr.DM 256/2022 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses.

Ankuesja e pakënaqur me vendimet e Departamentit të Burimeve Njerëzore me datë 10.02.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 659/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa me datë 28.02.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e nxjerrjes së vendimit meritore në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 10.02.2022 me numër protokollit 659/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e datës 04.02.2022 e parashtruar në departamentin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; E-mail zyrtar i datës 05.02.2022; Kopja e Konkursit e datës 14.01.202-28.01.2022 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ; Vendimi i datës 07.02.2022 me nr.DM 256/2022; Çertifikatë e muajit dhjetorë 2006; Vërtetim për punësim i datës 14.01.2022; Çertifikatë e datës 11.07.2012; Shkresë emërimi e datës 10.04.2001; shkresë emërimi i datës 09.04.2002; Kontratë e punës e datës 27.12.2009; Shkresë emërimi i datës 09.04.2005; Kontratë e punës e datës 30.08.2007; Njoftim i datës 03.02.2022 nga Departamenti i Burimeve Njerëzore për listën e ngushtë për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në AKP; Kontratë e punës e datës 22.12.2009; Çertifikatë e datës 29.11.2002; Letër rekomandimi për muajin shkurt 2016; Letër rekomandimi e datës 24.02.2020; Përgjigje në ankesë e datës 28.02.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 1043; Vendimi i datës 06.12.2021 me nr.ref.BD-155/3 për inicimin e procedurës për rekrutimin e pozitës Drejtor Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Kopja e Konkursit e datës 14.01.202-28.01.2022 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Lista e aplikantëve; Aplikacioni për Drita Gjonbalaj i datës 18.01.2022; Letër motivuese; Akt emërimi i datës 30.12.2011 me nr.ref.215/PRK 2 për pozitën Zyrtar i Prokurimit; Akt emërimi i datës 04.08.2014 me nr.ref.150/PRK 2 për pozitën Zyrtar i Prokurimit; Aktgjykimi A.nr.916/2017 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Akt gjykimi me nr.AA.nr.413/2017 i Gjykatës të Apelit të Kosovës; Aktvendimi nr.24/2018 i Gjykatës Supreme e Kosovës; Aktgjykim i me nr.ARI.nr.14/2017 i Gjykatës Supreme e Kosovës; Çertifikatë e datës 07.03.2002; Çertifikatë e muajit shtator-dhjetor 2006; Çertifikatë e vitit 2020; Çertifikatë e datës 28.06.2012; Çertifikatë e datës 27-31 .05.2002; Çertifikatë 12.07.2002; Çertifikatë e datës 29.11.2002; Çertifikatë e datës 13.07.2001; Çertifikatë e datës 04.10.2012; Diplomë e datës 22.11.2006; Diploma master e datës 24.11.2010 e lëshuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji-UBT; Diploma e datës 05.10.2020 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" për _____ ku ka marrë titullin Doktor i Shkencave Ekonomike në Fushën Menaxhment dhe Informatikë; Diplomë e datës 21.03.1989 me nr.4343 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; shkresë emërimi i datës 01.08.2000 ; shkresë emërimi i

datës 10.04.2001; shkresë emërimi i datës 09.04.2002; shkresë emërimi i datës 09.04.2002; Kontratë e datës 23.11.2005; Kontratë e datës 23.05.2007; Kontratë e datës 30.08.2007; Kopja e letërnjoftimit; Kontratë e datës 22.12.2009; Kontratë e datës 05.12.2006; Çertifikatë e kursit të gjuhës angleze e muajit shkurt-mars 2005; Letër rekomandimi muajit shkurt 2016; Letër rekomandimi nga Ministria e Financave; Konfirmimi i trustit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit; Letër me rekomandim e datës 24.02.2020; Vërtetim për punësim e datës 14.01.2022; Formulari për vlerësimin e detyrave në punë për vitin 2020 i datës 08.02.2020; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm , i ulët dhe profesional për vitin 2021 i datës 13.01.2022; Plani individual i Trajnimit i datës 13.01.2022; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës e datës 13.01.2022; Vendimi i datës 02.02.2022 me nr.ref.252/2022 i Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Lista e aplikantëve e aprovuar dhe e refuzuar; Njoftimi i datës 03.02.2022; Ankesë e datës 04.02.2022 e parashtruar në Departamentin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Vendimi me nr.ref.DM 256/2022 të datës 07.02.2022 i nxjerrë nga Departamentin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Njoftimi i datës 09.02.2022-që kandidatët e listës së ngushtë të vazhdojnë procedurën e mëtejme për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, aplikacionet e punësimit për kandidatët që janë pjesë e listës së ngushtë, njoftimi për pezullim të procedurës së regrutimit i datës 23/02/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses [REDAKTUAR] është e pabazuar *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 06.12.2021 ka nxjerrë vendimin me Nr.ref BD-155/3 për iniciimin e procedurës së regrutimit për pozitën Drejtor të Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit përmes konkursit publik, vendim i nënshkruar më datë 06/12/2021 ndërsa Departamenti i Burimeve Njerëzore sipas njoftimit të datës 15/12/2021ka shpallur konkursin publik me afatin për aplikim nga data 14.01.2022 deri më 28.01.2022 me numër reference.RN00007978 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, bazuar në dispozitat e nenit 40, paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.15/2020 për Pranim, Vlerësim dhe Disiplinë të Nivelit të Lartë Drejtues.

Konkursi sipas njoftimit të datës 15/12/2021 me afatin për aplikim nga data 14/01/2022 deri më 28.01.2022 me numër reference RN00007978 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to,*
- *Kualifikime të posaçme formale,*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tetë(8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë së paku pesë(5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar gjashtë (6) kandidatë, ankuesja për këtë pozitë të punës, ka

aplikuar me datë 18.01.2022 me numër reference RAN0002317, ndërsa me datë 02.02.2022 Departamenti i Burimeve Njerëzore ka nxjerrë vendimin me nr.DM 252 /2022 me të cilin ka refuzuar aplikacionin e znj [redacted] e cila nuk kualifikohet për procedurat e mëtejme të rekrutimit sepse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se "1. Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se edhe përkundër përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit jam e diskriminuar në aspekt gjinor sepse kandidatët që kanë hyrë në listën e ngushtë janë avancuar pa meritë. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit përmes vendimit të datës 06.12.2021 ka inicuar procedurën e rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues në AKP përmes konkursit publik, bazuar në Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034(të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.06/L-023,Ligjin nr.05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115),nenit 9.5 të Statutit të bordit të AKP-së, si dhe neneve 6,8,1,40 dhe 42 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 6.2 të rregullores Nr.15/2020 për pranimin, vlerësimin dhe disiplinën e nëpunësve të lartë drejtues, mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore janë paraparë edhe kërkesat e përgjithshme formale të konkursit të publikuar dhe mbi bazë të provave që kemi administruar me rastin e kësaj ankese të dorëzuar nga palët konstatohet se e njëjta përkundër që aludon në diskriminim me rastin që nuk ka hyrë në listë të ngushtë dhe se i është refuzuar ankesa për vazhdim të procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues në AKP, ankuesja nuk i ka plotësuar kushtet formalo-juridike të konkursit nga se e njëjta është e punësuar si zyrtare e prokurimit në këtë institucion sipas Akt emërimit të datës 04.08.2014 dhe bazuar në rregulloren Nr.26/2020 për klasifikim të vendeve të punës në shërbimin civil nuk klasifikohet në kategorinë e nëpunësve civil të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, por pozitë e nivelit profesional, poashtu edhe sipas strukturës organizative të AKP-së, bazuar në nenin 33 të rregullores Nr.26/2020, kjo pozitë është e nivelit profesional, e që është pengesë ligjore për aplikim në pozitë të nivelit të lartë drejtues.

Kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe rrethanave të konfirmuara nga përmbajtja e ankesës vërtetohet fakti se e njëjta nuk ka përvojë të mjaftueshme menaxheriale mbi bazë të arsyeve të ndryshme sipas pretendimit të saj por që për kolegjin nuk ishin relevante këto pretendime për faktin se nuk ndikojnë në vendimmarrje sa i përket objektit të kësaj ankese për arsyet e specifikuar më lartë, poashtu nga shkresat e lëndës konfirmohet fakti se kandidatët që janë pjesë e listës së ngushtë kanë përvojë të mjaftueshme menaxheriale dhe janë aktualisht në pozitë të nivelit të mesëm drejtues dhe i plotësojnë kriteret sipas këtij konkursi për pozitë të Drejtorit Menaxhues në AKP, dhe se ky fakt për dy nga kandidatët në listë të ngushtë është i konfirmuar edhe nga vetë ankuesja përmes ankesës së saj që pretendon se pozitë drejtuese i kanë të fituara në baza politike dhe jo profesionale, ndërsa kandidati B.S ka përvojë menaxheriale dhe ka qenë në nivel të lartë drejtues dhe aktualisht është në nivel të mesëm drejtues në Agjencinë për Informim dhe Privatësi me që rast i plotëson kriteret për të aplikuar për pozitë të nivelit të lartë drejtues, andaj edhe pretendimi ankimor për diskriminim gjinor



është i paqëndrueshëm për faktin se ankuesja nuk plotëson kriteret për aplikim sipas konkursit të potencuar më lartë, bazuar në legjislacionin në fuqi të shërbimit civil dhe se mbi këtë bazë vendimi i Departamentit të Burimeve Njerëzore Nr. DM 256/2022 i datës 07/02/2022 është nxjerrë në harmoni me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.113/2022, datë 15.03.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

